VENDIM
Nr.12, datë 28.1.2008

PËR MIRATIMIN E KOHËZGJATJES PËR FATURIMIN AFORFE PËR ABONENTËT FAMILJARË PA MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9, nenit 51, dhe nenit 52 datë ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, "Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH" sh.a. për kohëzgjatjen e faturimit aforfe të energjisë elektrike në abonentët familjarë pa aparat matje të energjie elektrike,

VENDOSI:

1. Kohëzgjatja për faturim aforfe për abonentët familjarë të energjisë elektrike pa matës të jetë deri në 31.12.2008.
2. Sasia e energjisë elektrike e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve) deri më 31.12.2008, do të jetë sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet OSSH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta